



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	15.02.2022
<b>Referenc-ë:</b>	
<b>Për/ Za/ To:</b>	“Europe House”
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit.
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga “Europe House” me përfaqësuese Arjeta Murati me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike dhe vendosja e një totemi me dimensione 200cm x 70cm në të cilin kalimtarët e rastit do të kenë mundësi ti përgjigjen me shkrim (në totem) pyetjes “Kush jam unë si grua?”.

Ky aksion rrugor do të organizohet nga Delegacioni i BE-së në bashkëpunim me Ambasadorët e rinj Evropian me datë 08.03.2022 në sheshin “Zahir Pajaziti” nga ora 12:00 deri në ora 14:00.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin “Europe House” për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Zahir Pajaziti” për vendosjen e një totemi me dimensione 200cm x 70cm me datë 08.03.2022 nga ora 12:00 deri në 14:00 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi;
- Mos të pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve;
- Pas përfundimit të aktivitetit hapësira të kthehet në gjendjen e mëparshme.

**Vërejtje:** pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.